

# S T A T U T I

## I SHOQERISE "NRAXHI"

KAPITALI THEMELTAR : 100.000 LEKE

ADMINISTRATOR I VETEM: **MUHAMET NRAXHI**

KREU I

EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1

Krijohet ne baze te ligjit nr.7512, date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" dhe ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "NRAXHI" sh.p.k.

Neni 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

Tregtim te artikujve ushqimore, industriale, te konsumit te qiere, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore si dhe blegtorale, kimikate, plehra kimike, pesticide me shumice e pakice, importi dhe eksporti, si dhe transportimin e tyre me mjete dhe te treteve.

### Neni 3

Shoqeria NRAXHI SH.P.K. eshte person juridik shqiptar. Kjo shoqeri fiton personalitetin juridik qe nga dita e regjistrimit te saj prane regjistrimit tregtar ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

### Neni 4

Selia e shoqerise eshte ne Shijak Durres, Me vendim te administratorit, shoqeria mund te krijojë filiale, perfaqesi dhe agjenci ne qytetin e Tiranes dhe ne qytete te tjera te vendit si dhe jashte tij. Filialet e ndodhura ne Shqiperi veprojne ne baze te legjislacionit shqiptar, ndersa ato jashte Shqiperise ne baze te legjislacionit te vendit ku ushtrojne veprimtarine e tyre.

### Neni 5

Jetegjatesia e shoqerise eshte mbi 10 vjet, me perjashtim te rasteve kur vendoset shperndarja e saj nga organi kompetent shoqeror si dhe ne rastin kur verifikohen rrethana te tilla qe shperndarja e saj parashikohet shprehimisht nga ligji.

## KREU II

### KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

### Neni 6

Kapitali themeltar eshte 100.000 leke. Ky kapital me vendim te ortakut te vetem mund te shtohet. Kapitali shoqeror mund te behet nga te holla ose nga kontribute ne natyre, te cilat vleresohen nga nje ekspert i emeruar nga ortaku i vetem. Nuk lejohet qe kapitali i shoqerise te perfaqesohet nga letra me vlere te tregtueshme apo sherbime.

### Neni 7

Kapitali shoqeror eshte i ndare ne kuota nga 1000 leke, per transferimin e te cilave te te tretet eshte plotesisht kompetent ortaku i vetem.

### KREU III

#### ORGANET E SHOQERISE

##### Neni 8

Ortaku i vetem eshte organi me i larte i shoqerise. Vendimet e tij regjistrohen ne librin e shoqerise.

##### Neni 9

I takon ortakut te vetem e drejta e ndryshimit te neneve te statutit, per rritjen e pakesimin e kapitalit themeltar te shoqerise, percaktimin e perfagesuesve te shoqerise, per shperndarjen e shoqerise, drejtimet kryesore te veprimtarise se shoqerise, kohezgjatjen e veprimtarise dhe shperndarjen e saj, ndryshimin e selise, krijimin e filialeve e shkrirjen e tyre, marrjen e kredive, miratimin e pages se punonjesve dhe cdo ceshtje tjeter qe e gjykon te arsyeshme.

##### Neni 10

Te gjitha te drejtat qe i takojne asamblese se ortakeve sipas ligjit "PER SHOQERITE TREGTARE" i takojne ortakut te vetem. Cdo person i interesuar mund te kerkoje ne gjykaten kompetente anulimin e vendimeve te ortakut te vetem te marra ne kundershtrim me dispozitat e udhezimet e ligjit dhe te ketij statuti.

### KREU IV

#### ADMINISTRIMI

##### Neni 11

Shoqeria administrohet nga nje administrator i vetem qe eshte z. Muhamet Nraxhi, i biri i Rizait dhe i Sudes, dtl.1939, lindur e banues ne Shijak.

##### Neni 12

Mandati i administrimit eshte per 10 vjet me te drejte rizgjedhjeje.

Neni 13

Administratori ka te drejte te kryeje cdo veprimtari administrative ne interes te shoqerise dhe brenda objektit te veprimtarise se saj ne marredhenie me te tretet, me perjashtim te atyre rasteve kur ligji ne menyre ekskluzive i ka caktuar asamblese se ortakeve, qe ne rastin e dhene ushtrohen nga ortaku i vetem.

Neni 14

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit dhe kur keto nuk perfshihen ne objektin e veprimtarise se shoqerise, me perjashtim te rasteve kur kjo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit tejkalonte objektin e veprimtarise se shoqerise.

Neni 15

Administratori i takon firma e shoqerise dhe perfagesimi i saj ndaj te treteve.

Neni 16

I ndalohej administratorit te kontraktoje me shoqerine ne cdo forme.

**KREU V**  
**BILANCI DHE FITIMET**

Neni 17

Ortaku i vetem emerou nje ose disa eksperte kontrabel, te cilet kane per detyre qe ne fund te cdo viti financiar te paraqesin bilancin dhe fitimet.

Neni 18

Viti financiar mbyllet cdo 31 dhjetor.

Neni 19

Ortaku i vetem i shoqerise ka te drejten ekskluzive mbi fitimet e shoqerise.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**  
**MUHAMET BRAXHI**

